Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VII
Sesioni Vjeshtor
Komisioni për Buxhet dhe Trasnfere
Mbledhja nr. 33/20
Prishtinë, më 04.12.2020, ora 10:00
Salla C-203, Ndërtesa e Kuvendit

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhjen morën pjesë deputetët: Hekuran Murati, Gazmend Abrashi, Mimoza Kusari Lila, Shkelzen Hajdini, Fatmir Rexhepi, Bedri Hamza, Kujtim Gashi dhe Veton Berisha.

Munguan deputetet: Verica Ceranic dhe Yllza Hoti.

Pjesëmarrës tjerë: Kushtrim Kemali - Këshilltar i GP-AAK, Labinot Smakaj - Këshilltar Ligjor nga Administrata e Kuvendit, Dren Ajeti – Këshilltar Ligjor nga Administrata e Kuvendit, Faton Fetahu – Këshilltar Ligjor në GP – PDK.

Nga stafi mbështetës i Administratës së Kuvendit: Vilson Ukaj dhe Sabrije Iseini.

Mbledhjen e kryesoi: Hekuran Murati – Kryetar (tutje kryetari).

Rendi i ditës:

1. **Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19**

Kryetari: Theksoi se tri komisionet tjera të përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19 dhe amendamentet e propozuara. Nuk kanë bërë ndonjë vërejtje të theksuar. Rekomandimet do të pasqyrohen në raportin me rekomandime të komisionit.

Bedri Hamza: Theksoi se në propozim-amendamentet që ka bërë në mbledhjen e kaluar të cilat janë përkrahur nga komisionit, në amendamentin 13 duhet bërë një korrigjim, fjalia "të regjistruara në regjistër të biznesit", duhet ndryshuar fjalinë "në ATK". Qëllimi i këtij ndryshimi është për faktin se jodomosdoshmërisht ka përputhje në mes bizneseve të regjistruara në ARBK dhe në ATK. Duke ditur që gjendja më reale e bizneseve aktive është në të dhënat e ATK-së, andaj propozojmë të bëhet ky ndryshim. Ndryshim dytë që propozojmë të bëhet ka të bëjë me shtimin e një amendamenti ti ri me të cilin riformulohet neni 12 i projektligjit sa i përket vlefshmërisë dhe të thuhet si vijon:

Neni 12
Vlefshmëria e Ligjit

1. Ky ligj mbetet në fuqi deri më 31.12.2021, përjashtimisht dispozitave të nenit 5 i cili zbatohet deri më 31.12.2028 dhe nenit 7 paragrafit 3.
2. Pas datës 31.12.2021, të gjitha dispozitat e këtij ligji do të shfuqizohen në mënyrë automatike, përveç atyre të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Duke ditur se ky projektligj shfuqizohet në fund të vitit 2021, është e domosdoshme që të bëhet ky ndryshim, në mënyrë që të bëhet e mundur zbatimi i nenit 5 që ka të bëjë me rimbursimin nga ana e Qeverisë, e kursimeve pensionale të tërhequra nga ata që kanë kursime deri në 9.900 euro. Si dhe të bëhet e mundur që lënda e parë e cila prodhohet nga bizneset aktive të regjistruara në Kosovë, pavarësisht a eksportohet jashtë vendit apo jo, të lirohet nga TVSH dhe kjo të vlejë edhe pas shfuqizimit të këtij ligji dhe e deri në rregullimin e kësaj çështje me Ligjin e TVSH-së.

Kryetari: Në rast se ne bëjmë ndryshime në amendamentet ekzistuese apo shtojmë amendamente të reja, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, na duhet që të përfillim procedurën që këto ndryshime ti dërgojmë për vlerësim në komisionet tjera të përhershme dhe të presim rekomandimet e tyre e pastaj të votojmë raportim final për Kuvendin.

Bedri Hamza: Propozimet e reja do ti paraqes në seancë.

Pas përfundimit të diskutimeve, dhe në bazë të rezultatit votimit, kryetari konstatoi se Komisioni me 6 vota Për, 2 vota Kundër dhe Asnjë votë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni miratoi Raportin me rekomandime për Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19 dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari Komisionit,

Hekuran Murati